



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë
Mbledhja nr. 95
Prishtinë, më 9.10.2024, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, Xhavit Haliti, Adelina Grainca, Yllëza Hoti, Gazmend Gjyshinca, Fitore Pacolli-Dalipi, Ariana Musliu-Shoshi dhe Time Kadrijaj.

Munguan: Doarsa Kica-Xhelili dhe Bahrim Shabani.

I pranishëm në takim: z. Aivo Orav, Udhëheqës i Zyrës së BE-së në Kosovë, me bashkëpunëtorë.

Pjesëmarrës të tjerë: Besarta Pllana, Lulzim Kelmendi, Alisa Thaçi, Leudita Mejzini, Muharrem Shtavica dhe Adriana Osmani- Kuvend.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Takimin e kryesoi Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

Takim me z. Aivo Orav, Udhëheqës i Zyrës së BE-së në Kosovë.

Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, i dëshiroi mirëseardhje z. Aivo Orav në këtë takim të përbashkët, e përgëzoi për emërimin në detyrë të re dhe i dëshiroi suksese në punë. Ky takim, tha se është i rëndësishëm për zhvillimin e bashkëpunimit të vazhdueshëm në fushën e tregtisë si dhe shkëmbimeve kulturore. Lidërshipi i juaj, tha se do të jetë padyshim në krye të diskutimeve që do t'i kemi për t'i forcuar marrëdhëniet tona.

Aivo Orav, falënderoi për ftesën që të jetë i pranishëm në komision dhe të bisedojnë për gjëra të përbashkëta. Zyra e BE-së në Kosovë, tha se nuk është një mision i zakonshëm, siç është në vendet e tjera të BP. Kosova dëshiron t'i bashkohet BE-së dhe BE-ja dëshiron të ketë zgjerim, që na jep një përgjegjësi më të madhe se sa ndaj ndonjë vendi tjetër, tha ai. Kjo nga fakti sepse ne përpiqemi që të njohim rrethanat e Kosovës, si një skaner që shikon të gjitha gjërat, verifikon të gjitha gjërat, se çfarë shkon mirë dhe çfarë duhet të përmirësohet. Sa i përket legjislacionit, tha se është e rëndësishme që ligjet të rregullohen gjatë leximit të dytë apo të tretë dhe se nuk e përkrasë procedurën e tërheqjes së ligjeve. Pyeti anëtarët e komisionit e cilat janë pritshmëritë e tyre ndaj zyrës së BE-së dhe se çfarë mund të planifikohet në muajt e vitet e ardhshme.

Xhavit Haliti, tha se është kënaqësi të takohemi me z. Aivo Orav, i cili ka marrë detyrën e re dhe ka një përvojë të gjatë pune. Në mes tjerash kërkoi të njoftohet nga z. Orav, se kur do të tërhiqen masat e vendosura nga BE-ja ndaj Kosovës dhe çfarë duhet të bëj Kosova për këtë, gjë për të cilën tha se është mirë të komunikojmë pa diplomaci për gjëra konkrete, për të cilat edhe ne si deputetë duhet të jemi të informuar krahas qeverisë. Mbështet qëndrimin e z. Orav se ligjet duhet të shqyrtohen dhe miratohen e jo të tërhiqen, por tek ne, tha se kur ato nuk i pëlqejnë kryeministrit, e jo BE-së, thuhet se nuk janë në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe shmangen ato ligje. Kërkoi nga z. Orav të dëgjojë se cilat janë detyrat tona kryesore dhe të domosdoshme që t'i kryejmë të gjithë së bashku për të filluar procesin e integritit të Kosovës në BE.

Aivo Orav, tha se komuniteti ndërkombëtar është prezent në Kosovë më shumë se në çdo vend fqinj. Do të punojmë rreth integritit dhe që BE-ja të jetë konsistente me kërkesa e jo të vij me ide kontradiktore. Mendimi i juaj, tha se është shumë i vlefshëm dhe do të jetë linja e parë në raportimin tonë në Bruksel. Sa i përket bojkotit, ne nuk e tolerojmë bojkotin e as që do të tolerohet në të ardhmen. Ai po ashtu, theksoi se instalimi i votimit elektronik për votim në parlament, është shumë i rëndësishëm.

Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, theksoi se ajo që presin nga përfaqësuesi i BE-së në mandatin e ri, duke pasur parasysh se ka një përvojë të madhe të diplomacisë e në veçanti me shtetet që e përfshinë Evropën Juglindore dhe e njeh politikë bërjen e tyre, se cila është mënyra më e mirë për të ndërtuar një komunikim të mirëfilltë në mes të vendeve, është shumë e rëndësishme të reflektojnë se çfarë do të jetë qasja e BE-së tani e tutje në kuadër të procesit të dialogut. Kjo do të ndikonte mandej edhe në uljen e tensioneve në krejt shtetet e BP, por në anën tjetër edhe për krijimin e njëfarë miqësie të mirëfilltë në mes të vendeve që do të bëjnë tregti të lirë, lëvizje të lirë e bashkë komunikojnë me njëra-tjetrën. Ajo theksoi se qeveria ka bërë një hap të mirë që ka tërhequr vendimin për lejimin e produkteve serbe që të hyjnë brenda Republikës së Kosovës që të mos jetë shkaktare e marrëveshjes së CEFTA-s, njëkohësisht që të mos shkaktojë probleme apo tensione në Procesin e Berlinit. Procesi i Berlinit ka qenë platforma kryesore nëpërmjet të cilit institucionet tona janë angazhuar që të ecin përpara rrugës, drejt BE-së. Znj. Kryeziu-Hyseni, theksoi se ka kaluar shumë kohë që Kosova vazhdon të mbetet padrejtësisht nën masa dhe kjo nuk është se nuk ka ndikim dhe nuk reflekton. Është e rëndësishme të diskutohet seriozisht dhe masat të tërhiqen menjëherë sepse ne e dimë që në mesin e 27 shteteve të BE-së, janë disa që nuk e pranojnë Republikën e Kosovës dhe problemi për tërheqjen e masave është i madh.

Aivo Orav, theksoi se kur znj. Ashton ishte përfaqësuese e BE-së, kanë ndodhur dy gjëra të mëdha, njëra ishte marrëveshja nukleare iraniane dhe marrëveshja tjetër ishte në mes të Kosovës e Serbisë dhe ky proces do të vazhdojë edhe kur të vijë përfaqësuesi i lartë i ri. Kjo ngase nuk është e mundur që të harrohet në këtë mënyrë ne si BE i sheh raportet ndërmjet dy vendeve dhe si do të mund të normalizohen këto marrëdhënie. Ai shtoi se e vlerëson atë se çfarë është Kosova duke bërë, sepse janë disa vende të cilat duhet t'i bëjnë këto veprime por nuk i bëjnë. Për vendet që duan t'i bashkohen BE-së, duke u ndërlidhur mbi standardet e dyfishta theksoi se tani BE është duke kërkuar më shumë nga vendet e reja sesa që ka kërkuar më parë, që është e natyrshme pasi që bota është duke ndryshuar dhe ato që kemi kërkuar dikur nga disa vende tani nuk janë të mjaftueshme. Sa i përket CEFTA-s, tha se ishte një punë shumë e mirë të cilën e kanë vlerësuar shumë ndërsa sa i përket masave theksoi se do të raporton dhe se diskutimet e bëra do të jenë të parat të cilat do t'i përmend në takim.

Gazmend Gjyshinca, e përgëzoi ambasadorin për mandatin e ri në këtë periudhë, për të cilën tha se është e vështirë dhe delikate edhe për botën edhe në raport me marrëdhëniet në mes të Kosovës e BE-së. Ai theksoi se vjen nga një brez i ri i politikanëve, shumica e votuesve të të cilëve janë përdorues të rrjeteve sociale që shpeshherë vendimmarrjet e tyre politike i ndërtojnë mbi informacionet që vinë nga rrjetet sociale e të informacionit. Kjo gjeneratë e ka pasur të vështirë të

kuptojë sjelljen politike të Brukselit e BE-së, në veçanti me Kosovën. Z. Gjyshinca tha, se beson se edhe z. Orav si ambasador i ri edhe ne si deputetë do të duhej të krijojmë një marrëdhënie ku ndihmohemi në mes njëri-tjetrit. Ne jemi të interesuar që të anëtarësohemi në BE, jo vetëm për shkak të standardeve jetësore që përfaqëson ky bashkim por edhe për shkak të vlerave dhe principeve. Në anën tjetër, tha se beson që ambasadori është i interesuar që ta përfundojë me sukses detyrën si ambasador e ta përfaqësojë sa më mirë BE-në në Kosovë e për këtë ne na duhet të jemi të sinqertë njëri me tjetrin, duke pasur parasysh realitetin social shoqëror që ekziston sot në Kosovë. Kësaj gjenerate, tha se 20 vite më parë i është premtuar një rrugë e qartë gjatë Samitit të Selanikut për anëtarësimin e rajonit në BE dhe sot jemi shumë larg kësaj, e në anën tjetër kemi Kosovën nën masa të BE-së. Tani gjenerata jonë e ka të vështirë ta kuptojë këtë situatë, duke parë sjelljen e BE në raport me situatat në botë dhe me një sjellje më radikale në Kosovë. Kjo situatë ka qenë një burim i konfuzitetit politik në raport me bindjen tonë për BE-në, dhe se do të duhej në të ardhmen të rikthejmë edhe njëherë besimin e jashtëzakonshëm të qytetarëve tanë për BE-në, duke i bërë punët mirë së bashku.

Aivo Orav, duke u ndërlidhur me parafolësin se duhet të jemi të sinqertë me njëri-tjetrin, theksoi se ai do të jetë i sinqertë por ndonjëherë nuk mund të thuhet të gjitha gjërat. Nga 27 vendeve të BE-së, 5 nga ato nuk e njohin pavarësinë e Kosovës dhe ndonjëherë këndvështrimet janë të ndryshme, tha ai. BE-ja tha se është e urryer ndonjëherë pos të tjerëve edhe nga vendet anëtare nëse diç nuk shkon si duhet në vendet e tyre, ata fajësojnë Brukselin. Lidhur me dialogun e ndërmjetësuar duke ju referuar një rasti, bëri me dije se nuk është punë e lehtë dhe se të dyja palët në dialog presin të bëjnë atë që tjetra dëshiron, dhe se çfarëdo që bëhet njëra apo tjetra palë është e pakënaqur. Duke pasur parasysh agresionin rus ndaj Ukrainës, njoftoi se është kthyer politika e zgjerimit dhe janë duke hapur dyert për gjithë Ballkanin Perëndimor. Ai theksoi se duhet të jemi gati dhe të përgatitur për procesin e integritetit, të kalohen testet e demokracisë, të cilat do të vlerësohen nga njerëzit nga Brukseli, që do të vinë të vlerësojnë a jeni të gatshëm për anëtarësim.

Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, theksoi se ky ishte një takim i parë kryesisht për tu njohur me njëri-tjetrin e për të shprehur gatishmërinë tonë për bashkëpunim dhe se komisioni deri në fund të legjislaturës është i gatshëm t'i përgjigjet çfarëdo lloj kërkesë ose nevojë për bashkëpunim nga Zyra e BE-së për çështje të interesit të përbashkët.

Aivo Orav, falënderoi komisionin për ftesën në takim dhe shprehu gatishmërinë për bashkëpunim.

Mbledhja përfundoi në orën 14:40.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Arbëreshë Kryeziu-Hyseni,

Kryetare e Komisionit